




*Gëzuar
Festat e
Fundvitit!*

Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Informacioni gjeohapësinor për temën “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”

ASIG, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar për temën “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”, informacionin gjeohapësinor të vitit 2023, i cili përfshin monitorimin e ajrit, ujërave të liqeneve, ujërave të lumenjve tributarët, ujërave të lumenjve, ujërave të shkarkimeve, monitorimin mikrobiologjik të ujërave, monitorimin e ujërave nëntokësorë, të ujërave të lumenjve për metalet e rënda dhe monitorimin e zhurmave urbane.

Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 210, datë 13.04.2023, për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”.



Informacioni gjeohapësinor për temën “Kufijtë e njësive administrative”




ASIG, në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për shtresat:

- Rendi 4 (Kufi njësive administrative), Bashkia Malësi e Madhe;
- Rendi 5 (Qytete dhe Fshatra), Bashkia Malësi e Madhe.

Kufijtë e përditësuar janë miratuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Malësi e Madhe, nr.14, datë 30.04.2020, "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale të Bashkisë Malësi e Madhe", në zbatim të nenit 93, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 1078, datë 23.12.2015, Për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, Tema: Kufijtë e njësive administrative”.


Zgjerimi i Hartës Bazë - Muriqan – Obot (Shkodër)

ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën "Harta bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të zonës Muriqan - Obot në Bashkinë Shkodër. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 17.9 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.




Publikimi në ArcGIS Online i Mbulesës së Tokës - Bashkia Rrogozhinë dhe Bashkia Cërrik

ASIG ka publikuar në ArcGIS Online, WebMap-in me shtresën e Mbulesës së Tokës për Bashkinë e Rrogozhinës dhe Bashkinë e Cërrikut, të cilat shërbejnë për planifikimin urban dhe zhvillimin e tyre, duke ofruar një pamje të detajuar të strukturës së mbulimit të tokës. ASIG po vijon punën për krijimin e hartës tematike "Mbulesa e Tokës" për të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore të territorit të Republikës së Shqipërisë.



Mbulesa e Tokës - Bashkia Cërrik



Mbulesa e Tokës - Bashkia Rrogozhinë

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

Pjesëmarrja e ASIG në Takimin e Komitetit Koordinues Teknik për Projektin NFFIS-NbS DRR

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në takimin e parë të Grupit Teknik Koordinues të projektit "Ndërtimi i Kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje (National Forest Fire Information System - NFFIS) dhe Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë për Zvogëlimin e Risqeve nga Fatkeqësitë (NbS-DRR)". Takimi u fokusua në ngritjen e kapaciteteve për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, duke krijuar Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje dhe duke aplikuar zgjidhje të bazuara në natyrë për kontrollin e erozionit, ku u prezantuan dy komponentë kryesorë: NFFIS, një sistem Web-GIS për menaxhimin e zjarreve, dhe NbS-DRR, që fokusohet në reduktimin e erozionit në Basenin e Pellgut Ujëmbledhës të Bovillës.



Pjesëmarrja e ASIG në Eventin Përmbyllës të Projektit SPATIAL II në Beograd

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në eventin përmbyllës të projektit SPATIAL II, i zhvilluar në datat 4-6 Dhjetor 2024 në Beograd, Serbi. Ky projekt, i organizuar nga Agjencia Holandeze Kadaster dhe mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, kishte për qëllim forcimin e aksesit në informacionin mbi tokën në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe mbështetjen për zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore. Pjesëmarrësit ndanë eksperiencat dhe arritjet e tyre, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të informacionit për tokën. Ky aktivitet shërbeu për forcimin e kapaciteteve të ASIG dhe zhvillimin e sistemeve të të dhënave gjeohapësinore në Shqipëri.



BOTA E GJEOINFORMACIONIT

Roli i Binjakëve Digjitalë në Zvogëlimin e Efekteve të Ishujve të Nxehetësisë Urbane

Ishujt e nxehetësisë urbane përkeqësojnë cilësinë e ajrit dhe ndikojnë negativisht në shëndetin publik. Binjakët digjitalë ofrojnë një zgjidhje inovatore për këtë problem, duke krijuar modele virtuale të qyteteve që mundësojnë simulime të ndërhyrjeve urbane, si shtimi i hapësirave të gjelbra ose ndryshimi i materialeve ndërtimore. Projekte si ai në Enschede, Holandë, dhe Wuppertal, Gjermani, tregojnë se binjakët digjitalë mund të përmirësojnë planifikimin urban dhe të krijojnë qytete më të qëndrueshme dhe rezistente ndaj klimës, duke përdorur të dhëna reale dhe përfshirje publike.

Shërbime dhe Aftësi të Reja për Galileo

Galileo, sistemi evropian i navigimit satelitor, ka arritur zhvillime të rëndësishme që nga fillimi i tij në 2016, duke iu shërbyer mbi 3 miliardë përdorues në mbarë botën. Përgjatë 2024, Galileo prezantoi Shërbimin e Lartë të Saktësisë (High Accuracy Service - HAS), që ofron saktësi decimetrike falas, dhe Autentikimin e Mesazhit të Navigimit (Open Service Navigation Message Authentication - OSNMA), që parandalon manipulimet e të dhënave. Përmirësimi i Shërbimit të Kërkimit dhe Shpëtimit (Search and Rescue - SAR) dhe lançimi i Shërbimit të Paralajmërimit Emergjent (Emergency Warning Satellite Service - EWSS) e bën Galileo një mjet të rëndësishëm për situata emergjente. Me satelitet e brezit të dytë (Galileo's Second Generation - G2G) në fazën e testimit, Galileo është duke udhëhequr inovacionin në teknologjinë e navigimit satelitor.

AKTIVITETE NË VIJIM

BIOSPACE25 - Biodiversity Insight From Space

Agjencia Evropiane e Hapësirës (ESA) së bashku me partnerët e saj organizon në Fraskati të Italisë, konferencën dedikuar aplikimit të Satelitit Remote Sensing (SRS) në dimensione të ndryshme të biodiversitetit, dhe adresimin e përdorimit të Vëzhgimeve të Tokës në të gjitha sferat, nga ekosistemet tokësore, të ujërave të ëmbla, bregdetare e deri te ato detare.

10 - 14 Shkurt 2025

www.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;



Commercial UAV Expo Europe

Ekspozita Komercale e UAV-ve të Evropës, aktiviteti kryesor për dronët komerciale, do të zhvillohet nga 8-10 prill 2025 në Amsterdam. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të zbulojnë strategji dhe zgjidhje të zbatueshme, të njohin përparimet më të fundit në teknologjinë ajrore dhe të krijojnë kontakte me profesionistë të industrisë.

8 - 10 Prill 2025

www.geoportal.asig.gov.al

E-mail: info@asig.gov.al

Telefon: +355 (0)42 223 762;